



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca Plenare
Seanca nr.2003/14
Prishtinë,më 8 maj 2003,në orën 11:15 minuta.
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës,salla plenare

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi Nexhat DAC,kryetar i Kuvendit të Kosovës,kurse bashkëkryesues ishte Gojko Saviq,anëtar i Kryesisë.

Kryesuesi konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 72 deputetë dhe shpalli të hapur punën e saj.

Në seancën e mëparshme ishte miratuar rendi i ditës i kësaj seance,si vjon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme.
2. Shqyrtimi i P/Kodit penal të Kosovës.
3. Shqyrtimi i P/kodit të procedurës penale të Kosovës.
4. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet.
5. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Transport dhe Postëtelekom.
6. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Tregti dhe Industri.
7. Parashtrimi i pyetjeve dhe
8. Përcatimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme pleare që duhet të mbahet më 15 maj 2003.

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit se shkak i vonesës së kësaj seanca ishte incidenti që kishte ndodhur në mes deputetëve Fadil Gecit dhe Gani Kocit,para se të hynin në seancë.

Kryesuesi tha se kishte marrë vendim që t'i përjashtonte nga punimet e kësaj seance të dy deputetët që ishin të përzier në këtë incident.

Kryesuesi kërkoi nga deputetët e Kuvendit që të procedohet sipas rendit të ditës të miratuar në seancën e mëparshme.

Gojko Saviq tha se ka vërejtje në pikat e 4,5 dhe 6 të rendit të ditës,ngase ato nuk janë miratuar në seancën e mëparshme dhe kërkoi që për to të deklarohen deputetët.

Ramadan Kelmendi kërkoi që në rend ditë të kësaj seance të rradhitet edhe çështja e sgrisë në Mitrovicë.

Dagisha Krstoviq pyeti sipas cilës procedurë janë radhitur shqyrtimet e rekomandimeve të komisioneve të Kuvendit?

Kryesuesi sqaroi procedurën e propozimit të rendit të ditës së kësaj seance nga Kryesia e Kuvendit dhe të miratimit të tij në seancën e mëparshme të Kuvendit dhe kërkoi që të procedohet sipas rendit të miratuar.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme.

Nuk pati vërejtje lidhur me procesverbalin e seancës së mëparshme dhe ai u miratua.

2. Shqyrtimi i P/kodit penal të Kosovës.

Kryesuesi i informoi deputetët për procedurën e hartimit ,shqyrtimit dhe të miratimit të këtij P/kodi dhe e ftoi nënkryetarin e Komisionit për Çështje Gjyqësore,Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese të Kuvendit që t'i arsyetonte rekomandimet e këtij Komisioni në këtë P/kod.

Kolë Berisha tha se P/kodi penal dhe P/kodi i procedurës penale janë ndër ligjet më të rëndësishme për Kosovën.Në hartimin e tyre kanë marrë pjesë ekspertë të njohur vendor dhe ndërkombëtar që kanë pasur për bazë ligjet dhe praktikat më të avancuara ndërkombëtare të kësaj fushe.

Komisioni për Çështje gjyqësore,Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese i ka shqyrtuar këto P/kode në gjashtë mbledhje dhe i ka analizuar në detaje 360 nene të P/kodit penal dhe 556 nene të P/kodit të procedurës penale.Gjatë shqyrtimit të tyre në Komision kanë marrë pjesë edhe përfaqsesit e Zyrës ligjore të kryeministrit,Zyrës ligjore të UNMIK-ut,të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe të Prokurorisë së Qarkut.Gjatë këtij shqyrtimi Komisioni i ka hartuar dhe i rekomandon Kuvendit që t'i miratojë disa amendamente me

të cilat do të përmirësohet cilësia e këtyre P/kodeve dhe i ftoi deputetët që t'i miratonin ato.

Lilana Keniq tha se këto P/kode nuk duhet t'i miratojë Kuvendi i Kosovës, por PSSP-ja.

Bujar Dugolli tha se Grupi Parlamentar i AAK-së ka vërejtje lidhur me emërtimin, kufijtë dhe masat ndëshkuese që parashihen në këto P/kode, por e përkrah miratimin e tyre.

Dragisha Krstoviq tha se koalicioni "Kthimi" nuk e përkrah miratimin e këtyre P/kodeve, ngase sipas tij, institucionet e Kosovës dhe ato ndërkombëtare, ngadalë por sigurt po e shpien Kosovën kah pavarësia saj.

Sabri Hamiti tha se Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah miratimin e këtyre P/kodeve.

Kryesuesi i vuri në votim amendamentet e Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese një nga një dhe Kuvendi i miratoi me shumicë votash amendamentet 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,15,16,17,18,19,20 si dhe sugjerimet në kapitullin e 13.

Kryesuesi e vuri në votim P/kodin në tërësi dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----shumica,
Kundër-----10,
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi Kodin Penal të Kosovës.

3. Shqyrtimi i P/kodit të procedurës penale në Kosovë.

Kryesuesi i vuri në votim amendamentet e Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese një nga një dhe Kuvendi me shumicë votash i miratoi amendamentet 1,2,3,4,5,6 dhe 7.

Kryesuesi e vuri në votim P/kodin e procedurës penale në tërësi dhe rezultati ishte si vijon:

Për----- shumica,
Kundër-----11,
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi Kodin e procedurës penale.

4. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe të Komisionit për Ekonomi dhe Financa për amendamentimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe të përgjegjësi.